

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin /L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr¹ i prokurimit

101-26-3243-2-1-1

Sa i përket tenderit për: **“Mirëmbajtja teknike e ndërtesës”**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

“Design Project Technology & Euro Commerce” Sh.P.K.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Dardania SU 3/1,LC1,
(Adresa)

Prishtine
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

049 379 100
(Numri Telefonit)

N/A

Arta Koliqi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

(Numri i Faks-it)

designprojecttechnology@gmail.com

(Adresa elektronike)



27.07.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 15.05.2026

Hapja e ofertave: 29.06.2026

Njoftimi mbi vendimin e AK: 09.07.2026

Kërkesë për qasje në dokumentacion : 09.07.2026 - **(Nuk është ofruar qasje fare)**

Kërkesa për rishqyrtim: 14.07.2026

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim: 17.07.2026

Ankesa në OSHP: 27.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Procesverbalin e hapjes e kemi pranuar përmes sistemit të E-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim me datë 14.07.2026.

Refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 17.07.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 – Qëllimi: Ky nen përcakton qëllimin e ligjit, i cili është të rregullojë procedurat për prokurimin publik në mënyrë të drejtë, transparente dhe konkurruese.

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti: Autoriteti kontraktues është i obliguar të sigurojë përdorim sa më efikas dhe ekonomik të fondeve publike gjatë procesit të prokurimit.

Neni 7 – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi: Të gjithë operatorët ekonomikë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të drejtë, pa diskriminim në asnjë fazë të procedurës së prokurimit.

Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve: Përcakton rregullat dhe kriteret për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave të dorëzuara nga operatorët ekonomikë.

Neni 62 – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit: Përfundimi i aktivitetit të prokurimit bëhet vetëm nëse një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh ose të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tej kalojnë buxhetin.

Neni 69 – Aftësia teknike dhe/ose profesionale: Kërkesat për dëshmimin e aftësive teknike dhe profesionale që duhet të përmbushin operatorët ekonomikë për të qenë të kualifikuar për kontratën përkatëse.

Neni 72 – Dokumentacioni dhe informacioni shtesë: Autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin.

Neni 97 Shkeljet e rënda i RREGULLORES Nr. 001/2022 - Shkelje të rënda konsiderohen: Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

AK/Komisioni vlerësues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Rregulloren e Udhëzimit operativ për prokurim publik.

AK/zyra e prokurimit me datë 09.07.2026 ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e AK, duke anuluar aktivitetin e prokurimit edhe pse oferta jonë plotëson të gjitha kërkesat dhe kriteret e shfaqura në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit nga ju si Autoritet Kontraktues. Në përputhje me nenin 108/A të LPP-së, me datë 14.07.2026 kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim, ndërsa refuzimin e kërkesës për rishqyrtim e kemi pranuar me datë 17.07.2026.

Refuzimi i kërkesës për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues nuk është i bazuar në fakte dhe nuk e pasqyrojnë gjendjen reale dhe faktike të procedurës së prokurimit.

Në vijim të kësaj ankese, do të paraqesim në mënyrë të qartë, të detajuar dhe të argumentuar për secilin nga pretendimet tona ankimore. Këto pretendime do të mbështeten në prova konkrete dhe dokumentacion përkatës, përmes të cilave vërehet qartë se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e LPP-së dhe me obligimet që burojnë nga dokumentet e tenderit.

Pretendimi 1 - Shkelja e të Drejtës për Qasje në Dokumentacion dhe Parimi i Barazisë në Trajtim

Në përputhje me nenin 7 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, më datë 09.07.2026 kemi dorëzuar kërkesë për qasje në dokumentacionin përkatës të aktivitetit të prokurimit. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk ka mundur qasjen në dokumentacionin e kërkuar.


Moslejimi i qasjes në dokumentacionin zyrtar të aktivitetit të prokurimit, përkundër kërkesës së shkruar të Operatorit Ekonomik dhe pas publikimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues, nuk paraqet vetëm shkelje procedurale, por një veprim të cilin legjislacioni i prokurimit publik e klasifikon si shkelje të rëndë.

Në kuptim të nenit 97.1 pika (c) të Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, moslejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumente zyrtare sipas kërkesës me shkrim të palës së interesit, kur kjo qasje është në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, përbën shkelje të rëndë.

Për më tepër, sipas nenit 99.2 të kësaj Rregulloreje, shkeljet e rënda të dispozitave të LPP-së dhe legjislacionit dytësor mund të sjellin masa disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit nga ana e Bordit të KRPP-së.

Prandaj, veprimi i Autoritetit Kontraktues ka cenuar parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe ushtrimit efektiv të së drejtës për ankesë, duke e bërë këtë shkelje me ndikim të drejtpërdrejtë në ligjshmërinë e procedurës së prokurimit.

Shih si argument – Dëshmia e dorëzimit të kërkesës për qasje në dokumente përmes platformës elektronike të e-Prokurimit



Nga evidenca elektronike e platformës së e-Prokurimit rezulton qartë se kërkesa me titull **“KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE -09.07.2026.pdf”** është dërguar te Autoriteti Kontraktues – **Kuvendi i Kosovës**, më datë **09.07.2026**, në ora **10:59**.

Në Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues pretendon në mënyrë të pasaktë se kërkesa për qasje në dokumentacion nuk i është dorëzuar.

Ky pretendim është plotësisht i pavërtetë dhe rrëzohet nga provat elektronike të sistemit të e-Prokurimit, të cilat vërtetojnë në mënyrë të pakontestueshme se kërkesa është dorëzuar përmes platformës zyrtare elektronike më datë 09.07.2026, në ora 10:59, drejtuar Autoritetit Kontraktues – Kuvendi i Kosovës. Si rrjedhojë, pretendimi i AK-së nuk ka asnjë mbështetje faktike apo juridike dhe nuk mund të përdoret si justifikim për moslejimin e qasjes në dokumentacionin e aktivitetit të prokurimit.

SHIH

Argument – Dëshmia që Autoriteti Kontraktues e ka pranuar, hapur dhe lexuar kërkesën për qasje në dokumente.

Dërguar në: KUVENDI I KOSOVËS

Dokumenti për dërgim te AK

KËRKESË PËR QASJE NË DOKUMENTE -09.07.2026.pdf

09.07.2026 10:59

Hape:

Shqip

Ngarko:

Shqip

Srpski

English

Dërgo

Pretendimi i Autoritetit Kontraktues se kërkesa për qasje në dokumentacion nuk i është dorëzuar është i pavërtetë dhe përgënjeshtrohet nga provat e bashkëlidhura, të cilat dëshmojnë qartë se kërkesa është pranuar, hapur dhe lexuar nga vetë Autoriteti Kontraktues përmes sistemit elektronik.

Ky mosofrim i qasjes përbën shkelje të parimit të trajtimit të barabartë dhe transparencës në procedurën e prokurimit publik, duke cenuar të drejtat tona si palë e interesuar.

Nenin 7 të **Rregullores Nr. 001/2022**, i cili përcakton qartazi se Autoriteti Kontraktues duhet të ofrojë qasje të shpejtë dhe efikase në dokumentacionin e tenderit dhe dokumentet relevante të procedurës.

Kjo sjellje administrative kufizon të drejtën tonë për të ushtruar një mjet efektiv ligjor brenda afatit të paraparë dhe cenon parimin e transparencës dhe drejtësisë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 97

Shkeljet e rënda

RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar

97.1 Shkelje të rënda konsiderohen:

a. Mashtrimi, kërcënimi, apo ushtrimi i çfardo presioni ose ndikimi të çfardo lloji që ushtrohet ndaj zyrtarit të prokurimit ose në një personi tjetër të përfshirë në një aktivitet të prokurimit në mënyrë që zyrtari tjetër të kryej vlerësimin në kundërshtim me këtë ligj.

b. Falsifikimi, **fshehja** apo eliminimi i dokumenteve gjatë zhvillimit të një procedure të prokurimit;

c. **Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare** sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Konform Ligjit për Prokurim Publik veprimet e ZPP-se konsiderohen shkelje të rënda, ku me këtë rast arrijmë deri te revokimi i çertifikatës profesionale të prokurimit.

Neni 99
Masat disiplinore për shkeljet të rënda
RREGULLORE PËR PROKURIMIN PUBLIK – Versioni i konsoliduar

99.2 Për shkelje të rënda të dispozitave të Ligjit të Prokurimit Publik dhe legjislacionit dytësor duke përfshirë edhe ato të specifikuara në paragrafin 97.1 të kësaj rregullore, Bordi i KRPP-së do të nxjerrë **vendim për anulim të çertifikatës së prokurimit dhe do të kërkojë nga autoriteti kontraktues marrjen e masave disiplinore ndaj personit në fjalë** në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, me veprimet e tij, ka bërë shkelje flagrante të dispozitave të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe të Rregullores Nr. 002/2024, duke pretenduar në mënyrë të pavërtetë se kërkesa për qasje në dokumente nuk i është dorëzuar. Ky pretendim përgënjeshtrohet plotësisht nga provat, të cilat dëshmojnë se kërkesa është pranuar, hapur dhe lexuar nga vetë Autoriteti Kontraktues përmes sistemit elektronik.

Një veprim i tillë përbën tejkalim të kompetencave ligjore të Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, duke cenuar parimet themelore të procedurave të prokurimit publik, veçanërisht parimin e ligjshmërisë, transparencës dhe sigurisë juridike të operatorëve ekonomikë. Për më tepër, një tejkalim i tillë krijon pasiguri në zbatimin e rregullave të prokurimit dhe cenon të drejtën e operatorëve ekonomikë për trajtim të barabartë dhe të drejtë gjatë procedurës.

Kërkojmë që ky pretendim të merret seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën e OSHP-së.

Pretendimi 2 - Eliminimi i padrejtë për kompaninë tonë lidhur me kualifikimet e stafit teknik

Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se ne si Operator Ekonomik nuk kemi dëshmuar kualifikimin formal të stafit të propozuar, me arsyetimin se certifikatat e dorëzuara nga AQSCERT nuk përbëjnë as diplomë të shkollës së mesme në profilin përkatës teknik dhe as Certifikatë Kombëtare mbi Aftësimin Profesional të lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK).

Ky vlerësim është tepër formalist dhe nuk merr parasysh qëllimin e kriterit të kualifikimit, përkatësisht verifikimin e aftësisë profesionale të personelit që do të angazhohet në realizimin e kontratës.

Ne si Operator Ekonomik ofertues kemi dorëzuar certifikata profesionale të lëshuara nga AQSCERT, i akredituar nga **Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit e Republikës së Shqipërisë** sipas standardit **ISO/IEC 17021-1**, me akreditim të vlefshëm dhe të njohur **ndërkombëtarisht**. Këto certifikata janë lëshuar nga një organizëm që vepron në përputhje me standardet ndërkombëtare të vlerësimit të konformitetit.

Prandaj, nuk mund të konkludohet se personeli nuk posedon aftësi profesionale vetëm për faktin se dokumenti nuk është emërtuar "Certifikatë Kombëtare mbi Aftësimin Profesional".

Qëllimi i kriterit të përcaktuar në Dosjen e Tenderit është të sigurojë që personeli i propozuar disponon njohuritë dhe aftësitë profesionale të nevojshme për realizimin e kontratës.

Ne si Operator Ekonomik kemi dëshmuar pikërisht këtë fakt përmes certifikatave profesionale të lëshuara nga një organizëm i akredituar.

Interpretimi i bërë nga Autoriteti Kontraktues kufizohet vetëm në emërtimin formal të dokumentit dhe nuk merr në konsideratë përmbajtjen, qëllimin dhe vlerën profesionale të certifikatave të dorëzuara.

Sipas parimeve themelore të prokurimit publik, autoriteti kontraktues është i obliguar të zbatojë kriteret në mënyrë proporcionale dhe në funksion të qëllimit të tyre.

Në rastin konkret, eliminimi i Operatorit Ekonomik vetëm për shkak të emërtimit formal të certifikatës, pa vlerësuar përmbajtjen dhe kompetencat që ajo dëshmon, përbën një masë joproporcionale që kufizon konkurrencën dhe bie ndesh me parimet themelore të prokurimit publik.

Dosja e Tenderit nuk përmban asnjë dispozitë sipas së cilës pranohen vetëm certifikata të lëshuara në Republikën e Kosovës ose që përjashtohen certifikatat profesionale të lëshuara nga institucione homologe të akredituara në shtete të tjera.

Sipas Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), Autoriteti Kontraktues **nuk mund ta eliminojë një operator ekonomik mbi bazën e një kriteri ose interpretimi që nuk është paraparë në Dosjen e Tenderit.** AK është i detyruar të zbatojë kriteret ashtu siç janë publikuar dhe nuk mund t'i ndryshojë ose t'i zgjerojë ato gjatë fazës së vlerësimit.

Autoriteti Kontraktues ka tejkalluar kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Dosja e Tenderit nuk ka përcaktuar se diplomat apo certifikatat profesionale duhet të jenë ekskluzivisht të lëshuara në Republikën e Kosovës ose se nuk pranohen dokumente ekuivalente të lëshuara nga institucione të akredituara jashtë Republikës së Kosovës. Gjatë procedurës së sqarimit, ne kemi dorëzuar dokumentacion që dëshmon se AQSCERT është organizëm certifikues i akredituar nga autoriteti kompetent shtetëror i Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk e ka shqyrtuar këtë dokumentacion, por ka vendosur eliminimin duke i shtuar kriterit një kufizim që nuk është përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Një veprim i tillë bie ndesh me parimet e transparencës, trajtimit të barabartë dhe sigurisë juridike, pasi operatorët ekonomikë nuk mund të vlerësohen vetëm mbi bazën e interpretimeve kufizuese të vendosura gjatë fazës së vlerësimit.

Një qasje e tillë përbën **shkelje të parimit të trajtimit të barabartë, transparencës dhe proporcionalitetit**, si dhe bie ndesh me praktikën e konsoliduar të prokurimit publik.

Egizston një fakt thelbësor dhe i pamohueshëm që jemi në përputhje të plotë, madje duke i tejkaluar kërkesat e përcaktuara në **Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit**.

Duke qenë se kemi plotësuar **kërkesën e AK** dhe për më tepër, kemi **tejkualuar kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit**, vlerësojmë se vendimi për eliminimin tonë është **i pabazuar**.

Në këtë rast, nëse komisioni i vlerësimit ka bërë gabim, **zyrtari përgjegjës i prokurimit** është person kompetent që **miraton ose refuzon rekomandimin**, prandaj mban **përgjegjësi të plotë** për miratimin e një rekomandimi të paligjshëm. Pra, **ne si OE kemi plotësuar kërkesat e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit** madje i kemi tejkaluar, dhe është fakt objektiv që **as komisioni, as ZPP nuk mund ta anashkalojnë pa cënuar ligjin**.

Veprimet e AK-së jo vetëm që janë të kundërligjshme, por edhe tregojnë qartë një qëllim diskriminues ndaj Kompanisë tonë, duke cenuar parimet themelore të barazisë dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik.

Kërkojmë që këto pretendime të merren seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikën/vendimet e OSHP-së.

Pretendimi 3-Anulimi i aktivitetit të prokurimit është në kundërshtim edhe me Nenin 62 të LPP-së

Nuk pajtohemi me vendimin për anulimin e aktivitetit të prokurimit, pasi ne kemi plotësuar **kriteret e përcaktuara në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit**, në mënyrë të plotë dhe të dokumentuar dhe anulimi është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Neni 62

Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

1.1. një shkellje i ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërin nga arsyet:

2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Pra, asnjëri kusht nuk është arritur për të anuluar aktivitetin, andaj ky veprim i AK bie ndesh edhe me nenin 7 të LPP-se (diskriminimi jonë nga ana juaj si AK), dhe nenin 59.4 të LPP-së

(pasi që oferta jonë është e përgjegjshme me cmimin më të lirë) dhe ju padrejtësisht e anuloni aktivitetin e prokurimit duke na diskriminuar neve si OE të përgjegjshëm.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur rëndë dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) dhe të Rregullores për Prokurimin Publik, duke anuluar në mënyrë të njëanshme aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me kushtet dhe procedurat e përcaktuara në nenin 62 të LPP-së, i cili rregullon përfundimin e aktivitetit të prokurimit. Një vendim i tillë është marrë në kundërshtim me ligjin, pa u mbështetur në bazat ligjore dhe faktike të kërkuara nga ky nen. Duke u bazuar në argumentet e lartcekura kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe njëkohësisht është arsyetim blanko, duke mos e dhënë asnjë arsyetim se përse pretendimet tona ankimore janë të pa bazuara. Andaj ky veprim i AK-së e tregon qartë faktin se **pretendimet tona ankimore janë të BAZUARA**.

Kërkojmë që edhe ky pretendim të merren seriozisht dhe të bëhet rishqyrtimi i vendimit në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar, me parimet themelore të LPP-së dhe me praktikat/vendimet e OSHP-së.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, duke na diskriminuar neve si Operator Ekonomik të përgjegjshëm me cmimin më të lirë dhe duke anuluar aktivitetin. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo ju nuk i jeni përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar edhe Nenin 6 të LPP-së edhe pse autoritetet kontraktuese janë të obliguar që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Gjithashtu Autoriteti Kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në faktet që u përmenden me lartë, kërkojmë nga **Organi Shqyrtues i Prokurimit** që të shqyrtoj ankesën tonë dhe të nxjerr:

VENDIM

I.APROVOHET, e bazuar kërkesa për rishqyrtim e OE **Design Project Technology & Euro Commerce SH.P.K., Prishtine, Kosovë**

II.OBLIGOHET Autoriteti Kontraktues- **Kuvendi i Kosovës**, që të kthejë lëndën në **Ri-vlerësim** dhe me rastin e ri-vlerësimit të ofertave të rekomandohemi për kontratë ne si Operatori Ekonomik i përgjegjshëm me cmimin më të lirë.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

- Kostot e përgatitjes së ofertës dhe dokumentacionin përcjellës,
- Dëmin ekonomik të shkaktuar nga humbja e një kontrate të mundëshme,
- Pengesën në realizimin e investimeve të planifikuara për këtë aktivitet

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mospara-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*